

# Pasqyrat Financiare 2024

Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2024

## 1. Informacion i per gjithshem

### Organizimi

Shoqeria "AMR" sh.p.k eshte krijuar si nje shoqeri me per gjegjesi te kufizuar me Vendim QKR CN-866622-02-15 Durres.

Veprimitaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr.9901dt.14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", dhe legjisacioni ne fuqi.

### Objekti dhe Kontributet

Shoqeria "AMR" sh.p.k ka si objekt kryesor Transport kombetar dhe nderkombetar i mallrave dhe produkteve te ndryshme ushqimore ,industriale , materialeve te ndertimit. Agjensi per pastrimin e mbeturinave urbane dhe industriale,me karakter publik apo privat, per sherbimet funerale ,mirembajtje,pastrim dhe gjelberim te mjedisit .

### Administrimi

Kapitali i shoqerise eshte ne shumen 100.000 leke dhe ortaku i shoqerise eshte z.Fadil Balla i cili zoteron 100 % te shumes se kapitalit.

Shoqeria drejtohet nga administratori i vetem i shoqerise z.Fadil Balla dhe eshte rregjistruar ne organin tatimor te qytetit te Durres me NIPT L51416504L.

## 2. Permblehdje e politikave kontabel

### Bazat e perqatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë perqatitur në përputhjeme ligjin 25/2018 Dt 10/05/2018 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë perqatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera sipas "parimit te te drejtave te kostatuara". Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (lekë). Veprimet janë hedhur ne menyre kronologjike dhe te kompjuterizuar ne programin "FINANCA 5". Veprimet janë ngurtesuar me 31.12.2024.

**Shifrat e paraqitura ne pasqyrat financiare te vitit 2024, jane te krahasueshme me ato te vitit 2023, pasi nuk ka ndryshime ne politikat kontabile.**


Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2024 eshte zbatuar formati i SKK-2

**Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, ne hartimin e pasqyrave financiare te vitit 2024, janë si më poshtë:**

Vijimesia e veprimitarise ekonomike e subjektit eshte e siguruar, pasi nuk ka ne plan nderprerjen e aktivitetit te tij ekonomik.

Kompensimi midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka, ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem kur lejohen nga SKK.

Kuptueshmeria e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote, per te qene te qarta dhe te kuptueshme per perdorues te jashtem, qe kane njojuri te per gjitheshme dhe te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.



# Pasqyrat Financiare 2024

Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2024

**Materialiteti** eshte vleresuar nga ana jone, dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.

**Besueshmeria** per hartimin e pasqyrave financiare eshte e siguruar, pasi nuk ka gabime materiale, duke zbatuar parimet e meposhteme:

- Parimin e paraqitjes me besnikeri.
- Parimin e perparese se permajtjes ekonomike mbi formen.
- Parimin e paanshmerise pa asnje influencim te qellimshem.
- Parimin e maturise pa optimizem te tepruar, pa nenvleresim dhje mbivleresim te qellimshem.
- Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te Pasqyrave Financiare.
- Parimin e qendrueshmerise per te mos ndryshuar politikat kontabel.
- Parimin e krahasueshmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

**Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve:** Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara, mbeshtetur ne dokumentacionin justifikues.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Shpenzimet e periudhes ushtrimore jane te krahasueshme dhe te lidhura me te ardhurat e te njejtes periudhe.


**Monedhat e huaja:** Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetare të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos fillestare te amortizuar dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2024 Jane 1 euro = 98.15 leke dhe 1 dollar = 94.26 leke.

**Tatimin mbi fitimin:** Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor.Tatim fitimi i pagueshem per vitin raportues, bazohet mbi fitimin e tatushem, i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2024 eshte 15% dhe per fitimet e realizuare ne veprimtarine pritëse, qe jemi të certifikuar si "agroturizëm" tatimi mbi fitimin eshte 5%..

**Kërkesat për t'u arkëtuar:** Kërkesat për t'u arkëtuar, llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provisionet e krijuara për rënien në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre nominale te amortizuar. (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

**Pasivet financiare:** Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre nominale te amortizuar neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).



# Pasqyrat Financiare 2024

Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2024

**Aktivet Afatgjata materiale:** Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejt përdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe mbi bazen e vleren se mbetur per pjesen tjeter te aktiveve te qendrueshme. Normat e amortizimit perdonura jane sipas ligjit 29/2023 dt.30.03.2023 "Per tatimin mbi te ardhurat" ne ndertesa 5 % mënyrë individuale sipas metodës lineare, per pajisjet informatike 25 % mënyrë individuale sipas metodës lineare dhe per aktivet e tjera 20% mënyrë individuale sipas metodës lineare..

**Gjendjet e inventaret:** Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi.Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve, vleresuar sipas metodes se kostos mesatare te ponderuar.

### 3. Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve te bilancit

Çelja e vitit 2024 rakordon me mbylljen e vitit 2023. Shumat e kolones "Ushtrim i Mbyllur" si ne aktiv dhe ne pasiv kapin shumen 582,349,795 leke.

### 4. Aktivet Afatshkurteria

Aktivet afatshkurteria ne pasqyrat financiare te vitit 2024 paraqiten sipas zerave me poshte:

**4.a Mjetet monetare** ne arke dhe banke me 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2024 jane si me poshte:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Para ne dore	9,483,642	12,916,729
Para ne Banka	2,085,785	27,894,922
<b>Totali</b>	<b>11,569,428</b>	<b>40,811,652</b>

Gjendjet e llogarive te liqiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejtë me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes, dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventareve fizik te monedhave. Gjendja e likuiditeteve ne monedha te huaja jane perkthyer me kurset e këmbimit, të përdorura nga Banka e Shqiperise, më 31.12.2024, te cilat jane 1 euro = 98.15 leke dhe 1 dollar = 94.26 leke.

**4.b Të drejta të arkëtueshme** perfaqesojne vleren e detyrimeve debitore, te cilat ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2024, deklarohen si vijon:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Nga aktiviteti i shfrytezimit	19,328,424	11,622,285
Te tjera	8,879,932	4,761,200



# Pasqyrat Financiare 2024

Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2024

Totali	28,208,356	16,383,485
--------	------------	------------

Ne llogarine "Nga aktiviteti i shfrytezimit " jane pasqyruar faturat e papaguara te shitjeve, qe jane te palikujduara ne fund te ushtrimit.

**4.b1 Te tjera të drejta të arketueshme** perfaqesojne vleren e detyrimeve debitore, te cilat ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2024, deklarohen si vijon:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Tedrejtë dhe detyrime ndaj ortakeve	2,500,182	2,164,200
Debitore te tjere	6,379,750	2,597,000
<b>Totali</b>	<b>8,879,932</b>	<b>4,761,200</b>

**4.c Inventaret** perfaqesojne gjendjen e inventareve ne fillim dhe ne fund te vitit ushtrimor si me poshte:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Te tjere inventar, Inventar i imet	24,400,229	23,010,724
Mallra	27,397,034	32,605,798
Parapagime për inventar	2,475,695	7,767,540
<b>Totali</b>	<b>54,272,958</b>	<b>63,384,062</b>

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit, dhe me inventarin fizik te kryer ne fund te ushtrimit. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit , eshte perdonur metoda e kostos "mesatare te ponderuar". Parapagimet per inventar ne vleren 2,475,695 leke, jane parapagime per furnizime qe do te vijnë ne periudhen e ardheshme.


## 5. Aktivet Afatgjata materiale (AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale per vitin ushtrimor 2024, ne pasqyrat financiare financiare paraqiten si me poshte:

	Ndertime dhe toka	Makin e paj.+mj.tr.	Te tjera	Totali
<i>Aktive te Trupozuara</i>				
Gjendje 01.01.2024	387,526,561	34,143,491	89,259,401	510,988,714
Shtesa	106,838,185	4,120,000	2,246,699	113,204,885
Pakesime		-	(4,160,790)	(4,160,790)
Gjendje 31.12.2024	<b>494,364,746</b>	<b>38,263,491</b>	<b>87,345,310</b>	<b>620,032,809</b>

<i>Amortizimi</i>				
Gjendje ne 01.01.2024	<b>14,282,040</b>	<b>14,001,736</b>	<b>20,934,342</b>	49,218,118
Shtesa llogaritur	17,626,745	4,107,017	13,045,092	34,778,854
Pakesime		-		-
Gjendje ne 31.12.2024	<b>31,908,785</b>	<b>18,108,753</b>	<b>33,979,434</b>	<b>83,996,972</b>

Vlera neto 01.01.2024	373,244,521	20,141,755	68,325,059	461,770,596
Vlera neto 31.12.2024	<b>462,455,961</b>	<b>20,154,738</b>	<b>53,365,876</b>	<b>535,976,576</b>



# Pasqyrat Financiare 2024

Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2024

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe I aktiveve afatgjata materiale (AAM-ve), te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme, jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike, qe shoqeria ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2024. Drejtimi mendon se per gjithesish per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlore te AAM-ve, dhe per rrjedhoje nuk ka llogaritur zhvleresime. Metodat dhe Normat e amortizimit perdonura jane sipas ligjit 29/2023 dt.30.03.2023 "Per tatimin mbi te ardhurat" ne ndertesa 5 % menyrë individuale sipas metodës lineare, per pajisjet informatike 25 % menyrë individuale sipas metodës lineare dhe per aktivet e tjera 20% menyrë individuale sipas metodës lineare. Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijt e njojur per efekte fiskale.

## 6. Detyrimet afatshkurteria

6.a "Detyrimet afatshkurteria" ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2024 paraqiten si vijon:



	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Detyrime ndaj institucioneve te kredise	625,529	0
Aktetime ne avance per porosi	3,027,934	45,187,829
Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	42,180,823	49,706,992
Te pagueshme ndaj punonj.dhe sig.shoqerore	12,316,219	9,312,159
Të pagueshme për detyrimet tatimore	4,365,303	16,462,263
Te tjera te pagueshme	58,890,000	74,805,920
<b>Totali</b>	<b>121,405,808</b>	<b>195,475,163</b>

"Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit" figuron per shumen 42,124,5 leke dhe pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve, per blerjen e mallrave dhe te sherbimeve, te cilat jane te palikujduara ne fund te viti ushtrimor, dhe do te likuidohen ne 12 muajt e ardhshem. Kjo llogari eshte e azhornuar dhe shuma e llogarive analitike, te mbajtura per cdo furnitor, eshte e barabarte me llogarine sintetike. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane vleresuar realisht. " Te pagueshme ndaj punonj dhe sig shoqerore "jane perfshire detyrimet e shoqerise ndaj punonjesve per pagat dhe per sigurimet shoqerore ne vleren 12,316,219 qe parfaqson detyrimin e muajit dhjetor 2024 qe do te likuidohen ne muajin janar 2025.

6.a.1 "Te pagueshme per detyrimet tatimore", te analizuara sipas zerave, ne fillim dhe ne fund te viti ushtrimor, paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Shteti Tvsh per tu paguar	3,899,568	4,598,959
Tatimi mbi te ardhurat personale	82,479	46,444
Tatim I mbajtur ne burim	69,000	69,000
Shteti Tatimi mbi fitimin	314,256	11,747,860
<b>Totali</b>	<b>4,365,303</b>	<b>16,462,263</b>

Detyrimi per shumen 3,899,568 leke perfaqeson detyrimin e tatimit mbi vleren e shtuar.



# Pasqyrat Financiare 2024

Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2024

Tatimi ne burim" per vleren 69,000 leke perfaqeson detyrimin e tatimit per qerane, i cili do te paguhet brenda afateve perkatese te parashikuara sipas ligjit. Detyrimi per shumen 314,256 leke eshte detyrimi per tatimin mbi fitimin i rezultuar nga deklarimi i vitit 2024.

**6.b "Detyrimet afatgjata"** ne fillim dhe ne fund te vitit ushtrimor paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	237,787,048	197,161,323
<b>Totali</b>	<b>237,787,048</b>	<b>197,161,323</b>

Detyrimet ndaj institucioneve të kredisë" perfaqeson detyrimin e shoqerise ndaj Bankave per kredine e marre ne leke dhe ne euro.

## **7. Kapitalet e veta**

Kapitalet e veta te shoqerise ne fillim dhe ne fund te vitit ushtrimor 2024, paraqiten sipas tabeles me poshte:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Katitali I nenshkruar	100,000	100,000
Rezerva ligjore	10,000	10,000
Rezerva te tjera	189,603,309	82,874,870
Fitimi I pashperndare	0	0
Fitimi/Humbja e vitit	81,177,449	106,728,439
<b>Totali</b>	<b>270,890,758</b>	<b>189,713,309</b>


"Kapitali aksioner" (fillestari) i shoqerise i paraqitur ne bilanc, eshte i njeje me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise, dhe te depozituara ne QKB. Per vitin 2024 kapitali nuk ka pesuar ndryshime. "Rezervat e tjera" gjate vitit ushtrimor 2023 jane zmadhuar sipas vendimit te ortakut, per miratimin e pasqyrave financiare 2023 dhe te depozituar ne QKB dhe ne organet tatimore. "Fitimi i vitit financiar perfaqeson fitimin neto te periudhes, pasi i eshte zbritur tatimi mbi fitimin. Ndryshimi i posteve te ndryshme te kapitalit, ne menyre dinamike paraqiten ne pasqyren perkatese te "Kapitaleve te veta", ndersa humbja (fitimi) e vitit financiar paraqitet ne "Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve".

## **8. Fitimi (humbja) e vitit financiar**

### **8.a Te ardhurat nga aktiviteti I shfrytezimit.**

Te ardhurat e realizuara gjate periudhes ushtrimore 2024, paraqiten sipas zerave te tabeles me poshte:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	404,418,061	379,642,650
<b>Totali</b>	<b>404,418,061</b>	<b>379,642,650</b>



# Pasqyrat Financiare 2024

Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2024

Te ardhurat nga "Shitia e mallrave" dhe "Te ardh.te tjera te vepr.e te shfrytezimit" jane vleresuar me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme, duke marre parasysh shumen e skontimeve, ose rabatet e ofruara, dhe perfaqesojne shitjet e mallrave te realizuara te dokumentuara me fature tatumore shitje te fiskalizuara. Te ardhurat e deklaruara nga subjekti ne FDP dhe ne sistemin informatik jane; 367,508,133 leke dhe rakordojne me te ardhurat e kekluara ne Selfcare. Te ardhurat e raportuara ne deklaratene vjetore te Tatim Fitimit jane 416,777,518 leke dhe jane raportuar me shume se te ardhurat e deklaruar ne FDP dhe Selfcare per shumen 49,269,385 leke, nga te cilat jane stornime te parapagimeve qe kane kaluar ne te ardhura per vleren 36,909,928 dhe te ardhura nga kembimet valutore per vleren 12,359,457 leke.

## 8.b Shpenzimet

Shpenzimet e realizuara si konsumi i materialeve, mallrave, shpenzimet e tjera nga veprimtaria e shfrytezimit, jane rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme sipas dokumentacionit baze, faturave tatumore. Shpenzimet e personelit jane pasqyruar sakte si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2024, jane pasqyruar ne pasqyren perkateze te Performances.

Shpenzimet e analizuara sipas zerave paraqiten si me poshte:

### 8.b.1 Shpenzimet per "Mallrat, lendet e para dhe material te konsumueshme" sipas zerave, paraqiten si vijon:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Materiale te para	97,730,613	77,340,130
Shpenzime te tjera materiale	78,736,467	37,990,424
<b>Totali</b>	<b>176,467,080</b>	<b>115,330,554</b>

### 8.b.2 "Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit" sipas zerave analitike, paraqiten si vijon:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Qera	5,520,000	12,354,800
Mirembajtje dhe riparime	971,330	1,516,311
Primi i sigurimit	205,298	457,421
Sherbime te tjera	5,875,212	7,830,597
Komisione	4,696,277	1,029,324
Personel jashte ndermarjes	825,000	900,000
Reklame publicitet	294,056	692,640
Shpz.postare e telekom	462,043	364,096
Transporte per blerje	299,340	
Sherbime bankare & kom Garancie	2,137,100	1,679,190
Taksa vendore	1,406,069	2,297,556



# Pasqyrat Financiare 2024

Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2024

Te tjera tatime e taksa	1,067,004	421,402
Shpenzime te tjera per personelin	1,504,200	1,023,835
Sponsorizime	0	188,128
Shpz.te padokumentuara sipas ligjit	759,660	0
Gjoba dhe demshperblime	187,123	0
<b>Totali</b>	<b>26,209,711</b>	<b>30,755,300</b>

Blerjet e raportuara ne FDP dhe SIT krahasuar me blerjet e rapotuara ne Pash dhe Bilanc rakordojne plotesisht

## 8.b.3 “Shpenzimet per personelin” paraqiten si me poshte:

	<i>31 Dhjetor 2024</i>	<i>31 Dhjetor 2023</i>
Paga	56,968,568	51,964,219
Sigurime shoqerore	9,613,892	8,792,913
<b>Totali</b>	<b>66,582,460</b>	<b>60,757,132</b>

## 8.b.4. “Te ardhurat dhe shpenzimet financiare” ne fillim dhe ne fund te periudhes ushtrimore paraqiten si vijon:

### -Te ardhurat dhe shpenzimet nga kembimet valutore

ne fillim dhe ne fund te periudhes ushtrimore paraqiten si vijon:

	<i>31 Dhjetor 2024</i>	<i>31 Dhjetor 2023</i>
Fitim nga kembime valutore monetare	17,915,019	26,703,506
Humbje nga kembimet valut. monetare	(5,555,561)	(8,828,152)
<b>Totali</b>	<b>12,359,457</b>	<b>17,875,353</b>

### -Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

ne fillim dhe ne fund te periudhes ushtrimore paraqiten si vijon:

	<i>31 Dhjetor 2024</i>	<i>31 Dhjetor 2023</i>
Te ardhura nga interesat	894	4,488
Shpenzime nga interesat	(16,163,171)	(12,794,333)
<b>Totali</b>	<b>(16,162,277)</b>	<b>(12,789,845)</b>

Te ardhurat dhe shpenzimet per kembimet valutore, jane paraqitur ne pasqyrat financiare te viti ushtrimor per diference, sipas kerkesave te SKK Nr.12. Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat jane paraqitur gjithashtu per diference sipas kerkesave te standardeve, dhe perfaqesojne interesat e paguara per kredite e marra.

## 9. Fitimi neto

Shpenzimet per tatimin mbi fitimin, dhe fitimi neto i shoqerise per periudhen ushtrimore, paraqitet si vijon:



# Pasqyrat Financiare 2024

Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2024

## Fitimi (Humbja) e viti financiar

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022.
Fitim Bruto	125,596,068	62,920,401
Shpenzime te pa njojura	188,128	366,424
a. Gjoba, penalitete, demshperblime	188,128	50,212
b. Shpenzime te padokumentuara sipas ligjit		316,212
Baza llogaritjes Tatimit	125,784,196	63,286,825
% e tatim Fitimit	15	15
<b>Tatim Fitimi</b>	18,867,629	9,493,024
<b>Fitimi Neto</b>	106,728,439	53,427,377

## 9. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se hartimit te pasqyrave financiare. Nga analiza e performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin e viti 2024 shoqeria rezulton me fitim te konsiderueshem..

Kontabel i Miratuar  
( Xhevdet HYSANI )



Administratori  
(Fadil BALLA )

